

Kodi deontologjik i arkivistëve

Miratuar nga Asambleja e përgjithshme e Këshillit ndërkombëtar të arkivave gjatë sesionit të 13-të, mbajtur në Pekin (Kinë) më 6 shtator 1996.

Hyrje

- A. Kodi deontologjik i arkivistëve ka për qëllim të ndihmojë profesionin e arkivistëve me rregulla për një punë të nivelit të lartë.
Kodi duhet të sensibilizojë më të rinjtë në këtë profesion me këto rregulla, tu kujtojë arkivistëve me përvojë përgjegjësitë e tyre profesionale dhe të ngjallë te publiku besim në këtë profesion.
- B. Fjala “arkivist”, në kuptimin që është dhënë në këtë tekst, përdoret për të gjithë ata përgjegjësia e të cilëve është të kontrollojnë, të marrin përsipër, të përpunojnë të mbrojnë, të ruajnë dhe të administrojnë arkivat.
- C. Organizmat punëdhënës dhe shërbimet arkivore janë inkurajuar të miratojnë politika dhe praktika që lejojnë zbatimin e këtij kodi.
- D. Ky kod është caktuar të jetë një kuadër etik pune për arkivistët dhe jo për të dhënë zgjidhje specifike për problem të vecanta.
- E. Të gjitha nenet shoqërohen me shpjegime që trajtojnë dhe ilustrojnë principin e dhënë, nenet dhe shpjegimet formojnë një të tërë dhe kështu krijojnë tekstin e plotë të kodit.
- F. Zbatimi Kodit varet nga dëshira e mire e institucioneve të arkivave dhe të shoqatave profesionale. Ai mund të arrihet përmes formimit dhe zbatimit të procedurave që parashtrijne orientime në raste ngurrimi, shqyrtojnë sjellje në kundërshtim me etiken, dhe, në qoftë se është nevoja, marrin masa.

KODI

1. Arkivistet ruajnë integritetin e arkivave duke garantuar kështu që arkivat përbejnë një deshmi të se kaluarës së gjatë që meriton besimi.

Detyra e parë e arkivistëve është të ruajnë integritetin e dokumenteve që varen prej kujdesit dhe mbikqyrjes së tyre. Në përmbushjen e kësaj detyre, ata respektojnë të drejtat dhe intereset, ndonjëherë të papajtueshme, të punëdhënësve të tyre, të pronarëve, të personave të përmendur në dokumente dhe të përdoruesve të shkuar, të tanishëm dhe

te ardhshem. Objektiviteti dhe paanesia e arkivisteve bejne te mundur matjen e shkalles se profesionalizmit te tyre. Arkivistet I rezistojne cdo presioni, ngado qe te vije, qe synon te manipuloje deshmite, si per shembull te fshehe ose te shtremberoj faktet.

2. Arkivistet trajtojne, seleksionojne dhe mirembajne arkivat ne konteksin e tyre historic, juridiki dhe administrative, duke respektuar keshtu preardhjen e tyre, duke ruajtur dhe beret e qarta lidhjet e tyre te perbashketa ne preardhje.

Arkivistet veprojne ne perputhje me parime dhe praktika pergjithesisht te njohura. Ne permbushjen e misionit dhe detyrave te tyre arkivistet pajtohen me parimet arkivistike, duke percaktuar krijimin, administrimin dhe zgjedhjen e destinacionit te arkivave aktuale dhe te ndermjetem, seleksionimin dhe marrjen e dokumenteve me qellim arkivimin e tyre perfundimtar, mbrojtjen, ruajtjen e arkivave per te cilet kane pergjegjesi si dhe klasifikimin, analizen, publikimin dhe mjetet per ti bere dokumentet te aksesueshme. Arkivistet perzgjedhin me paanesi dokumente, duke bazuar gjykimin e tyre ne nje njohje te thelle te kerkesave administrative dhe te politikave te marrjes nga institucionet burimore. Ata klasifikojne dhe analizojne dokumentet e zgjedhura per ruajtje ne perputhje me parimet arkivistike (vecanerisht ne perputhje me parimin e preardhjes dhe atij te klasifikimit te orgjines) dhe me norm ate njohura boterisht, dhe kjo sa me shpejt te jete e mundur. Arkivistet kane nje politike te marrjes se dokumenteve ne perputhje me objektivat dhe burimet e institucioneve nga ku dokumentet vijne. Ata nuk kerkojne ose nuk pranojne dokumente kur keto te fundit perbejne nje rrezik per integritetin ose sigurine e dokumenteve, aata bashkepunojne qe keto dokumente te ruhen ne vendet e duhura. Arkivistet favorizojne riatdhesimin e arkivave te zhvendosur.

3. Arkivistet ruajne autencitetin (vertetesine) e dokumenteve gjate perpunimit, ruajtjes dhe shfrytezimit.

Arkivistet veprojne ne menyre qe vlera arkivistike e dokumenteve, duke nenkuptuar dokumentet elektronike ose informatike, te mos zvogelohet nga punet arkivistike te zgjedhjes, klasifikimit dhe inventarizimit, ruajtjes dhe shfrytezimit. Ne qofte se duhet punuar me mostra, arkivistet e mbeshtesin vendimin e tyre ne metoda dhe kriteret te vendosura qarte. Zevendesimi I origjinaleve me bartes te tjere vendoset duke u nisur

nga vlera e tyre ligjore, qenesore dhe informuese. Kur dokumente qe nuk perdoren per konsultim, jane nxjerre per momentin nga dosja, kjo i behet e ditur perdoruesit.

4. Arkivistet sigurojne ne vazhdimesi komunikimin dhe kuptimin e dokumenteve

Arkivistet e drejtojne reflektimin e tyre ne perzgjedhjen e dokumenteve per tu ruajtur ose asgjesuar, ne rradhe te pare ne sherbim te domosdoshmerise se mbrojtjes se kujteses se veprimtarise se personit ose institucionit qe I ka prodhuar ose grumbulluar ato , si dhe ne sherbim te rritjes se ineteresave te kerkimit historic. Arkivistet jane te ndergjegjshem qe marrja e dokumenteve me origjine te dyshimte, edhe kur ato kane interest e madh, eshte e tille qe nxit nje tregti te palighshme. Arkivistet u japin ndihme kolegeve te tyre dhe sherbimeve kompetente per indentifikimin dhe ndjekjen e personave te dyshuar per vjedhje te dokumenteve arkivore.

5. Arkivistet pergjigjen per perpunimin e dokumenteve dhe perligjin menytrat e perpunimit.

Arkivistet nuk merren vetem me grumbullimin e dokumenteve ekzistuese, por ata bashkepunojne gjithashtu me administruesit e dokumenteve, ne menyre qe ne sistemet e informimit dhe te arkivimit elektronik te kihen parasysh, qe ne fillim, procedurat e percaktuara per mbrojtjen e dokuemneteve me vlere te perhershme. Kur arkivistet hyjne ne bisedime me sherbimet qe do te dorezojne dokumente ose me pronaret e dokumenteve, e bazojne vendimin e tyre, ne rast nevojje, ne te gjithë elementet e meposhtem: autorizim per dorezim, dhurim ose shitje, procedurat financiare, plani i perpunimit, te drejttat e riprodhimit dhe kushtet e komunikimit. Ata mbajne nje gjurme te shkruar te hyrjeve te dokumenteve, ruajtjes dhe perpunimit te tyre.

6. Arkivistet lehtesojne hyrjen ne arkiva per nje numer sa me te madh perdoruesish dhe mundesojne sherbimet e tyre me paanshmeri dhe per te gjithë perdoruesit.

Arkivistet krijojne mjete kerkimi te pergjithshme dhe te vecanta qe u pershtaten kerkesave per teresine e fondeve qe kane ne ruajtje. Arkivistet japin, ne cdo rrethane, keshilla me paanesi dhe perdorin burimet e disponueshme per te ndihmuar ne menyre te ekuilibruar. Arkivistet pergjigjen me miresjellje dhe me synimin per te ndihmuar te gjitha kerkimet e arsyeshme mbi dokumentet qe kane ne ruajtje dhe nxitin perdorimin e tyre sa me te madh ne numer ne kufijte e vendosur nga politika e institucioneve per te cilave ato varen, domosdoshmerine per te ruajtur dokumentet, respektimin e

legjislacionit, te rregullores, te drejtave te individeve dhe te mareveshjeve me dhuruesit. Ata motivojne kufizimet e mundeshme per kerkuesit dhe I zbatojne ato me paanesi. Arkivistet i shmangin kufizimet e aksesit dhe te perdorimit te dokumenteve, kur ato jane te paarsyeshme, por mund te pranojne, madje te sugjerojne kufizime te qarta dhe per nje kohezgjatje te kufizuar, kur keto kufizime jane kushti i nje marrjeje ne dorezim. Ata vezhgojne rregullisht ne menyre strikte dhe zbatojne me paanshmeri te gjitha marreveshjet qe jane kryer ne momentin e marrjes ne dorezim, por, ne interes e liberzimit te aksesit ne dokumente, arkivistet mund te ridiskutojne klauzolat (pikat) e marreveshjes, kur ndryshojne rrethanat.

7. Arkivistet synojne te gjejne ekuilibrin e duhur, ne kuader te legjislacionit ne fuqi, midis se drejtes per dije (informacion) dhe respektit te jetes private.

Arkivistet kujdesen qe jeta e personave morale dhe e individeve, ashtu si dhe siguria kombetare, te mbrohen pa qene nevoja te shkatërrohen informacione, sidomos ne rastin e arkivave informatike, ku fshirja dhe regjistrimi I te dhenave jane praktike e zakonshme. Arkivistet kujdesen per respektimin e jetes private te personave qe jane burim ose subject I dokumenteve, sidomos per ato dokumente qe nuk kane qene te konsultueshme ose per te ardhmen e tyre.

8. Arkivistet u sherbejne interesave te te gjithëve dhe shmangin perfitimin e avantazheve ne menyre te padrejte per veten e tyre ose per kedo qofte.

Arkivistet nuk pajtohen me asnje aktivitet te demshem per integritetin e tyre profesional, objektivitetin dhe paanshmerine. Arkivistet nuk nxjerrin nga aktiviteti I tyre asnje perfitim personal, financiar ose ten je natyre tjeter qe mund te jete ne dem te institucioneve, te perdoruesve dhe te kolegeve te tyre. Ata shmangin aktivitetet qe mund te krijojne publiku pershtypjen e nje konflikti interesash. Arkivistet mund te shfrytezojne fondet e arkivave te institucionit te tyre per qellime kerkimore dhe botime personale, mjaft qe kjo pune te kryhet sipas te njejtave rregullave me ato qe jane te detyrueshme per perdoruesit e tjere. Ata as nuk nxjerrin as nuk perdorin informacionet qe mund te kene marre gjate punes se tyre me fondet e arkivave shfrytezimi I te cilave eshte I kufizuar. Ata nuk lejojne qe kerkimet ose botimet e tyre personale te perzihen me misionet profesionale ose administrative, per te cilat ata jane punesuar. Lidhur me shfrytezimin e fondeve te arkivave te tyre, arkivistet nuk perdorin dijenine e tyre per

zbulime te bera nga nje kerkues qe nuk I ka publikuar ende, pa e lajmeruar ate me perpara per qellimin e tyre per te nxjerre perfitime. Arkivistet mund te kritikojne dhe te shpjegojne punet e aferta me fushat e tyre te kerkimit, perfshire ketu edhe punet e frymezuar nga fondet te cilat ata kane ne ruajtje. Arkivistet nuk I lejojne askujt jashte profesionit te tyre te nderhyre ne praktikat dhe detyrat e tyre.

9. Arkivistet kerkojne te arrijne nivelin me te larte profesional duke perterire sistematikisht dhe ne menyre te vazhdueshme njohurite e tyre arkivistike dhe duke ndare rezultatet e kerkimeve dhe eksperiencen e tyre.

Arkivistet perpiqen te avancojne dijet e tyre profesionale dhe njohurite e tyre teknike, te kontribuojne ne progresin e arkivistikes, dhe te kujdesen qe personat qe e kane per detyre, te mbikqyrin, te keshillojne dhe te formojne, ta bejne kete me competence.

10. Arkivistet punojne ne bashkepunim me koleget e tyre si dhe me punonjes te profesioneve te peraferta me qellim qe te sigurojne teresisht ruajtjen dhe shfrytezimin e pasurise kombetare.

Arkivistet kerkojne te nxisin bashkepunimin dhe te shmangim konfliktet me koleget e tyre, duke zgjidhur veshtiresite permes inkurajimit per respektimin e normave arkivistike dhe etikes profesionale. Arkivistet bashkepunojne me perfaqesuse te profesioneve paralele ne nje fryme respekti dhe mirekuptimi reciprok.